



Në fillim bëjmë njetin duke bërë “Eudhubil-lahi mineshejtanirr-rraxhim Bismil-lahirr -rrahmanirr -rrahim: *Bëj njet për të fal namazin (synet ose farz) të vaktit* ”

Tekbiri fillestar: (All-llahu ekber). Gjatë marrjes së tekbitit sytë shohin tek vendi i sexhdes. Pjesa e brendshme e duarve drejtohet nga kibla. Për meshkujt gishtat e mëdhenj prekin të butët e veshëve. Për femrat duart ngrihen drejtë me gjoksin ndërsa gishtat nuk e kalojnë lartësinë e supeve.



Qëndrimi në këmbë: sytë shohin tek vendi i e sexhdes. Duart lidhen nën kërthizë, dora e djathtë vendoset mbi dorën e majtë dhe e rrethon atë me gishtin e madh dhe të vogël.

Femrat i vendosin duart mbi gjoks dhe dora e djathtë qëndron mbi të majtën. Këmbët mbahen paralel drejtë kibles dhe katër gisht larg njëra-tjetrës.

Këtu këndohen **Subhaneke** duke thënë “Eudhu-bismillah” këndohet **Fatiha**’ja dhe një **sure** ose **tre ajete** nga **Kur’ani** e pastaj me tekbir shkohet në ruku.



Në ruku sytë shohin tek majat e gishtave të këmbëve, koka dhe shpina mbahen në të njëjtin drejtim. Kurrizi mbahet drejtë paralel me tokën. Meshkujt gishtat e duarve i mbajnë të hapur mbi kupat e gjunjëve. Femrat i mbajnë gishtat e mbyllur dhe duart qëndrojnë pak më lart se kupat e gjunjëve. Koka dhe kurrizi nuk qëndrojnë drejtë, koka qëndron pak më lart se kurrizi. Në ruku thuhet “**Subhane rab-bijel adhim**” tre herë.



Gjatë ngritjes nga rukuja themi “Semiall-llahu limen hamide” dhe kur drejtohem komplet themi “Rabbena lekel-hamd”. Pastaj duke thënë All-llahu ekber shkojmë në sexhde.



Balli dhe hunda prekin në tokë, koka qëndron mes dy duarve, bërrylat qëndrojnë anash trupit dhe nuk prekin në tokë, barku nuk duhet të preki tek kofshët. Gishtat e këmbëve drejtohen nga kibla dhe thembrat bashkohen me njëra-tjetrën. Ndërsa femrat bërrylat prekin në tokë dhe qëndrojnë ngjitur me trupin, barku takon tek kofshët, këmbët shtrihen anash dhe pjesa e sipërme e këmbëve prek në tokë.





Në sexhde thuhet: “Subhane rab-bijel a’la” tre herë. Nga sexhdeja ngrihet duke thënë All-llahu ekber dhe në mes dy sexhdeve thuhet “Rab-bigfiri” Sytë shohin tek kofshët duart vendoset mbi kofshë dhe gishtat lihen të lirë, për meshkujt këmba e majtë shtrihet në tokë dhe ulemi mbi të ndërsa këmba e djathtë mbahet pingul me gishta të drejtuar nga kibla. Për femrat dy këmbët nxirren në anën e djathtë nuk ulen mbi këmbën e djathtë por mbi tokë.



Pastaj shkohet përsëri në sexhde dhe në sexhde thuhet “Subhane rab-bijel a’la” tre herë. Pastaj duke thënë All-llahu ekber ngrihemi në këmbë.



Qëndrimi në këmbë: sytë shohin tek vendi i e sexhdes. Duart lidhen nën kërthizë, dora e djathtë vendoset mbi dorën e majtë dhe e rrethon atë me gishtin e madh dhe të vogël. Femrat i vendosin duart mbi gjoks dhe dora e djathtë qëndron mbi të majtën. Këmbët mbahen paralel drejtë kibles dhe katër gisht larg njëra-tjetrës. Këtu duke filluar me **Bismil-lah** këndohet **Fatiha**’ja dhe një **sure** ose **tre ajete** nga **Kur’ani** e pastaj me tekbir shkohet në ruku. .



Në ruku sytë shohin tek majat e gishtave të këmbëve, koka dhe shpina mbahen në të njëjtin drejtim. Kurrizi mbahet drejtë paralel me tokën. Meshkujt gishtat e duarve i mbajnë të hapur mbi kupat e gjunjëve. Femrat i mbajnë gishtat e mbyllur dhe duart qëndrojnë pak më lart se kupat e gjunjëve. Koka dhe kurrizi nuk qëndrojnë drejtë, koka qëndron pak më lart se kurrizi. Në ruku thuhet “**Subhane rab-bijel adhim**” tre herë.



Gjatë ngritjes nga rukuja themi “Semiall-llahu limen hamide” dhe kur drejtohem komplet themi “Rabbena lekel-hamd”. Pastaj duke thënë All-llahu ekber shkojmë në sexhde.





Balli dhe hunda prekin në tokë, koka qëndron mes dy duarve, bërrylat qëndrojnë anash trupit dhe nuk prekin në tokë, barku nuk duhet të preki tek kofshët. Gishtat e këmbëve drejtohen nga kibla dhe thembrat bashkohen me njëra-tjetrën. Ndërsa femrat bërrylat prekin në tokë dhe qëndrojnë ngjitur me trupin, barku takon tek kofshët, këmbët shtrihen anash dhe pjesa e sipërme e këmbëve prek në tokë.



Në sexhde thuhet: “Subhane rab-bijel a’la” tre herë. Nga sexhdeja ngihet duke thënë All-llahu ekber dhe në mes dy sexhdeve thuhet “Rab-bigfirli” Sytë shohin tek kofshët duart vendoset mbi kofshë dhe gishtat lihen të lirë, për meshkujt këmba e majtë shtrihet në tokë dhe ulemi mbi të ndërsa këmba e djathtë mbahet pingul me gishta të drejtuar nga kibla. Për femrat dy këmbët nxirren në anën e djathtë nuk ulen mbi këmbën e djathtë por mbi tokë.



Pastaj shkohet përsëri në sexhde dhe në sexhde thuhet “Subhane rab-bijel a’la” tre herë. Pastaj duke thënë All-llahu ekber dhe qëndrojmë të ulur.



Sytë shohin tek kofshët duart vendoset mbi kofshë dhe gishtat lihen të lirë, për meshkujt këmba e majtë shtrihet në tokë dhe ulemi mbi të ndërsa këmba e djathtë mbahet pingul me gishta të drejtuar nga kibla. Për femrat dy këmbët nxirren në anën e djathtë nuk ulen mbi këmbën e djathtë por mbi tokë.



Pasi këndojmë lutjet “Et-tehij-jatu” “Salavatet” dhe “Rab-bena atina fid-dunja” japim nga e djathta në të majtë selam duke thënë “Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi ve berakatuhu. Kështu falen të gjithë namazet, nëse namazi është katër rekatësh përsëritën të njëjtat gjëra.

Dhe pas namazit bëhen tespihet e pastaj duaja.

